



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:238502

Datë: 02.03.2022

Numri i dokumentit: 02768281

**P.nr.1172/21**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL** Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Halime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit A.M. nga .... me numër personal .... për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga Neni 321te KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren -PP/II.nr.1552-5/21,të datës 25.10.2021 ,per kërkesën per dhënien e urdherit ndëshkimor,jashtë shqyrtimit gjyqësor ,gjykata me datë 02.03.2022 mori dhe përpiloi, këtë:

## **A K T G J Y K I M**

A.M. nga i ati A. dhe e ema Sh. i lindur me daten .... në .... me nr.personal .... ka të kryer shkollën fillore,i pa martuar ,i pa punë,i gjendjes së dobët ekonomike,shtetas i Republikës së Kosovës:

### **ESHTE FAJTOR**

Se me dt 11.05.2020 rreth orës 23.30 ne ....ne vendin e ashtuquajtur .... me dalje ne dalje te Mamushes ne drejtim te fshatit .... i pandehuri me dashje dhe i vetëdijshtëm se me nje veprim te tille mund ta dëmtoj apo asgjësoj pasurin e tjetrit,duke u pajtuar me nje pasojë te tille,i pandehuri natën kritike e asgjëson,dëmton duke e bere te papërdorshme pasurinë e të dëmtuarit B.M. dhe ate duke prere"plastiken,najlonin e seres ",me qka te dëmtuarit i ka shkaktuar dëme materiale ne vlere rreth 350.00 euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 të KPRK-se.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 495 te Kodit të Procedures Penale jep këtë:

### **URDHER NDESHKIMOR**

PRANOHET kërkesa e Prokurorise Themelore ne Prizen-Departamenti i Pergjithshem,per dhënien e urdherit ndëshkimor PP/II.nr.1552-5/21 te datës 25.10.2021

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 4,7,8,9,10,43,69,70,dhe nenit 321 par.1 te KPRK-se dhe nenit 365 te KPPRK-se te akuzuarit i shqipton:

### **DENIM ME GJOBE**

shumen prej 160 euro te cilën është i obliguar ta paguajë brenda 15 diteve nga marrja e dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Nëse i akuzuari dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë, konform nenit 43 te KPRK-se,i njehti do te zëvendësohet me burgim, duke llogaritur nje dite burg-20 euro ,konkretisht 8 dite burg konformë nenit 43 par.3 te KPRK-së.

I dëmtuari B.M. per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sa ata bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, në emër te paushallit gjyqësore shumen prej 30 euro brenda 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, si dhe ne emër të fondit per kompensimin e viktimave te krimit ,te paguajë shumen prej 20 euro brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

### **ARSYETIM**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.1552-5/21 te datës 25.10.2021 kundër të akuzuarit A.M. për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 321, paragrafi 1 të KPK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit te shkresave te lendes dhe provave që gjinden ne shkresat e lendes , gjyqtari ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 p.1 te KPPK-se, dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPPK-së vendosi qe ta pranoje kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Pas shikimit te shkresave te lendes dhe provave që gjinden ne shkresat e lendes , gjyqtari ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 p.1 te KPPK-se, dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPPK-së vendosi qe ta pranoje kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë raporti i oficerit me numër te rastit 2020-GM-27 m3 date 12.05.2020,procesverbali mbi intervistimin e te pandehurit A.M. te dhene në Stacionin Policor ne Mamushe me date.12.05.2020;procesverbali mbi intervistimin e te dëmtuarit B.M. te dhene me date 12.05.2020;procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit Sh.M. te dhene me date 12.05.2020 ne Stacionin Policor ne Mamushe; procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit K.M. ,te dhene me date 12.05.2020 ne Stacionin Policor ne

Mamushe;procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit A.M. te dhene ne Stacionin Policor ne Mamushe;procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit A.M. te dhene me date 12.05.2020 ne Stacionin Policor ne Mamushe; procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit S.M. te dhene me date 14.07.2021 ne Stacionin Policor ne Mamushe si dhe fotodokumentacioni dhe shkresat e tjera, u vërtetua se i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te aktgjykimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës se dëmtuar per realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u mor në kuptim të nenit 450 dhe 451 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Me sa u tha me larte, ne kuptim te nenit 365 te KPPK-se, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE PRIZREN**

### **DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2021:238502, 02.03.2022**

**G j y q t a r i**

---

Refki Piraj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.